



VENDIM

NR. 101 DATË 07.06.2017

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURAT E INSPEKTIMIT TË VEPRIMTARISË
AUDIOVIZIVE TË OFRUESVE TË SHËRBIMIT MEDIATIK AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIV”**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje nenit 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat
audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e Regullores “Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian SALA

Zëvendëskryetar:

Sami NEZAJ

Anëtarë:

Agron GJEKMARKAJ

Gledis GJIPALI

Piro MISHA

Suela MUSTA

Zyliftar BREGU

RREGULLORE

PËR

PROCEDURAT E INSPEKTIMIT TË VEPRIMTARISË AUDIOVIZIVE TË OFRUJESVE TË SHËRBIMIT MEDIATIK AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIV

KREU I

QËLLIMI DHE SHTRIRJA, BAZA LIGJORE, PËRKUFIZIMET DHE PARIMET

Neni 1

Qëllimi i Shtrirja

- Qëllimi i kësaj rregullorejë është që të përcaktojë procedurat dhe parimet në lidhje me realizimin e të drejtave dhe përbushjen e detyrimeve të subjekteve që ofrojnë shërbime mediatike audiovizive, në rastet kur Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ushton kontroll të veprimtarisë audio dhe/ose audiovizive të tyre, në zbatim të dispozitive të Ligjt nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tjii.
- Kjo rregullore përcakton të drejtat dhe detyrimet e personave të autorizuar të AMA-s, gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, si dhe të gjitha palëve, që janë subjekti inspektime.

Neni 2

Baza ligjore

- Kjo rregullore është përgatitur në bazë të legjislacionit specifik të mëposhtëm:
 - Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
 - Ligji nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to";
 - Ligji nr. 99/18, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 8096, datë 21.03.1996 "Për kinematografinë", i ndryshuar;
 - Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative";
 - Ligji nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë";
 - Ligji nr. 8435, datë 28.12.1998 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Kjo rregullore mban parasysh edhe aktet nënligjore në zbatim të ligjeve të përmendura në pikën 1 të këtij nenit.

Neni 3

Përkufizimet

Termat e përdorur në këtë Rregullore do të kenë të njëtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe në rast se nuk janë të përkuffuar në ligj, do të jenë në përpunhje me direktivat e BE-së për komunikimet elektronike, AVMSD-në, aktet e ITU-së dhe CEPT-it (Konferenca Evropiane e Postës dhe Telekomunikacioneve) në fuqi.



AUTORITETI
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

Rruga "Abdi Toptani", 1001, Tiranë | www.ama.gov.al
Tel. +355 4 2226288 | Email. info@ama.gov.al

Neni 4

AMA, në mënyrë që të realizojë një inspektim sa më efektiv, do të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

1. Parimet e përgjithshme:

- Traitim i drejtë dhe jo diskriminues i të gjithë subjekteve, gjatë aktivitetave të inspektimit.
 - Sigurimi i konfidencialitetit të informacionit, të dhënavë dhe dokumenteve të sigurara gjatë aktivitetave të inspektimit, përvëç rasteve të parashikuara me ligj.
 - Paanshmëria gjatë kryerjes së inspektimit, vlerësimi të rezultateve dhe hartimit të akteve përkatëse.
 - Parandalimi i çfarëdolloj ndërhyrjeje, qoftë nga brenda, apo jashtë AMA-s, që mund të ndikojë në ndershëmëri, ose paanshmëri.
 - Traitim me kujdes dhe përgjegjshmëri i secilës fazë të aktivitetit të inspektimit.
 - Pajtueshmëri me parimet e përgjithshme të inspektimit, pavarësisht parimeve të listuara në këtë nen.
- Parimi i pavareësisë së inspektimit, sipas të cilët, AMA, brenda kompetencave të dhëna me ligj apo akt nënligjor, është plotësisht i pavarur në kryerjen e procedimit të inspektimit dhe marrijen e vendimeve për një rast konkret.
 - Parimi i proporcionalitetit në veprimtarinë e inspektimit, sipas të cilët:
 - Në kryerjen e inspektimit, AMA kryen veprimet e inspektimit në mënyrë të tillë që të ndërhyjë në veprimtarinë e subjektit të inspektimit vetëm për aq sa është e domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të inspektimit.
Në përcaktimin e dënimit apo të masës që duhet marrë, AMA, në përputhje me rëndësinë e shkeljeve të konstatuara apo pasojave të tyre, vendos atë sankzion apo merr atë masë që është domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të dënimit apo masës dhe që cenon më pak të drejtat apo interesat e ligjishme të subjektit të inspektimit.

KREU II

RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR INSPEKTIMIN

Neni 5

Urdhri i inspektimit

- Inspektimi kryhet në bazë të urdhrit të inspektimit.
- Kryetari i AMA-s, në bazë të urdhërit të inspektimit, autorizon inspektorët për të realizuar inspektime në përputhje me kriteret dhe rastet e parashikuara në legjispcionin organik.
- Inspektorët përzgjidhen nga Drejtoria e Mbikëqyrjes. Në raste të veçanta, inspektor mund të jetë edhe një nëpunës tjetër i specializuar i administratës së AMA-s, ose një person tjetër i specializuar, i cili mbulon fushat përkatëse të objektit, apo çështjes për të cilën kryhet inspektimi.

Neni 6

Përbajtja e urdhrit të inspektimit

- Në urdhrin e inspektimit përcaktohen, të paktën, këto elemente:
 - emri, ose emërtimi dhe adresa e subjektit të inspektimit;
 - objekti i inspektimit;
 - data e lëshimit;
 - identiteti i inspektorëve, duke përcaktuar edhe kryetarin e tyre.
 - kur ka, identiteti i personave të tjera të specializuar;
 - kohëzgjatja, në ditë, për kryerjen e inspektimit;
 - të dhënët e identifikimit, pozicioni dhe nënshkrimi i personit që ka lëshuar urdhrin.
- Adresa e subjektit që i nënshtronhet inspektimit është adresa e deklaruar dhe regjistruar pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe/ose ajo e regjistruar sipas legjispcionit në fuqi për shoqëritë tregtare. Kur subjekti që i nënshtronhet inspektimit, ka më shumë se një adresë, për ushtrimin e aktivitetit të tij, urdhri i shtrin efektet e tij edhe në këto adresat.

3. Në rastin kur objekti i inspektimeit është zbatimi i ligishmërisë prej disa apo gjithë subjekteve që operojnë në një apo disa njësi administrative të aktuara, në vend të emrit apo emërtimit dhe adresës së subjektit të inspektimeit, sipas pikës 1/i të këtij neni, në urdhër shënohet/n njësia/njësitë administrative që do të inspektohen.

KREU III

PROCEDURA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMEIT

SEKSIONI 1

Personat pjesëmarrës në inspektimeit dhe njoftimi i inspektimeit

Neni 7

- Inspektorët e autorizuar për të kryer veprime inspektimei**
1. Inspektimi kryhet nga inspektorët e përcaktuara në urdhrin e inspektimeit, të ndarë në grupe inspektime të përbërë nga jo pak se 3 (tre) inspektore.
 2. Zëvendësimi i një inspektori, të përcaktuara në urdhrin e inspektimeit mund të bëhet vetëm me urdhër të veçantë, që i injoftohet pa vonesë subjektit të inspektimeit dhe, sidoqoftë, përparrë fillimit të veprimeve nga inspektori i ri.
 3. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektime, inspektori identifikohet me dokumentin përkatës të institucionit.

Neni 8

Mbështetja e veprimeve të inspektimeit

1. Inspektorët e autorizuar për inspektime, për përcaktimin e faktave dhe rrëthanave të nevojshme, me qëllim marrjen e një vendimi përfundimtar, mund të kërkojnë bashkëpunim, ose ndihmë të specializuar, ose informacione dhe/ose të dhëna të tjera të nevojshme nga nëpunës, organe publike, eksperti, ose subjekte private.
2. Subjektet, e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtat e përcaktuara nga ligji dhe kjo rregulllore për inspektorët dhe nuk mund të marrin vendime procedurale apo përfundimtare për inspektime. Sidoqoftë, ata kanë detyrimin të mos përhapin, ose përdorin të dhënat që lidhen me veprimtarinë personale, tregtare, ose profesionale të subjektit të inspektimeit apo të personave të tjera të përfshirë, që mbrohen sippas legjisacionit në fuqi dhe me të cilat njihen gjatë inspektimeit.

Neni 9

Njofthimi i inspektimeit

1. Filimi i inspektimeit i njofthet subjektit të inspektimeit paraprakisht, ose njëkohësisht me filimin e veprimeve të inspektimeit, nëpërmjet dorëzimit të urdhrit të inspektimeit, përfaqësuesit të subjektit të inspektimeit.
2. Në raste të veçanta, filimi i inspektimeit mund të njofthet edhe përmes telefonit, në numrin, ose një prej numrave të telefonit të personit të kontaktit që subjekti i inspektimeit ka deklaruar në AMA, sipas parashikimeve lijore në fuqi.
3. Njëkohësisht me njoftimin e mësipërm, në çdo rast, inspektorët, përparrë fillimit të veprimeve të inspektimeit, informojnë përfaqësuesin e subjektit që inspektohen për objektin e inspektimeit dhe për të drejtat dhe detyrimet e tij, sipas lijit, si dhe për pasojat lijore të mosrespektimit të këtyre detyrimeve.

Neni 10

Vendi i inspektimeit

1. Vendi i inspektimeit, pavarësisht adresës së përcaktuara në urdhrin e inspektimeit, mund të jetë:
 - (i) kudo ku ushtron veprimtarinë e tij audio dhe/ose audiovizive subjekti që inspektohen dherëndodhen faktet dhe rrethanat, që lidhen me respektimin, ose mosrespektimin e kërkesave lijore;

176



(ii) në zyrat e organit inspektues, nëse nga natyra e inspektimit është i mundur të kryhet inspektimi.

2. Në rastin e parashikuar në pikën 1/ii të këtij nenit, subjekti i inspektimit ftohet të paraqitet në zyrat e organit. Nëse është e nevojshme, subjektit që inspektohet mund t'i kërkohet të paradesë, gjatë inspektimit, ose në zyrat e organit inspektues, dokumente, sende, apo të dhëna të tjera, të nevojshme për inspektimin.

2. Në rastin e parashikuar në pikën 1/ii të këtij nenit, subjekti i inspektimit ftohet të paraqitet në zyrat e organit. Nëse është e nevojshme, subjektit që inspektohet mund t'i kërkohet të paradesë, gjatë inspektimit, ose në zyrat e organit inspektues, dokumente, sende, apo të dhëna të tjera, të nevojshme për inspektimin.

Neni 11

Koha për kryerjen e inspektimit

Veprimet e inspektimit zhvillohen në çdo kohë, pavarësisht nga kohëzgjatja normale e punës së personave të autorizuar apo subjektit që inspektohet.

SEKSIONI 2

Të drejtat dhe detyrimet e subjektit të inspektimit

Neni 12

Të drejtat e subjektit të inspektimit

- Subjekti i inspektimit ka këto të drejta gjatë inspektimit:
1. Të kërkojë të njihet me urdhrin e inspektimit para fillimit të inspektimit;
 2. Të kërkojë identifikimin e inspektorëve;
 3. Të jetë present dhe të ndjekë, vetë, ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, të gjitha veprimet e inspektoimit;
 4. Të paraqesë mendimet, shpjegimet për faktet, rrethanat apo edhe për çështjet ligjore, që kanë të bëjnë me inspektimin, apo të paraqesë propozimet e tij për zgjidhjen e çështjes dhe dokumentet, ose materialet përkatëse ku i mbështet ato;
 5. Të kërkojë të njihet dhe t'i njoftohet procesverbalit i inspektimit;
 6. Të paraqesë kontestimet e tij për vlerësimin e provave të administruara, për rezultatet e hetimit dhe për vendimin që synohet të merret.

Neni 13

Detyrimet e subjektit të inspektimit

Përveç sa parashikohet nga ligji i posaçëm, subjekti i inspektimit ka këto detyrime gjatë veprimtarisë së inspektoimit:

1. Të ketë, ose të vërë në dispozicion të paktën një punonjës, ose një person të autorizuar prej tij, në çdo kohë (24 orë në ditë, për 7 ditë të javës), në vendin/mjediset ku janë të vendosura pajiset audio dhe/ose audiovizivë. Punonjësi, ose personi i autorizuar në fjalë konsiderohet si përfaqësues i subjektit që inspektohet dhe ka të njëjtë të drejta dhe detyrime gjatë inspektimit;
2. Në rast se nuk dëshiron, ose nuk ka mundësi të komunikojë drejtpërdrejt me inspektorët, të caktojë një përfaqësues, si dhe t'i shoqërojë ata në çdo vend/mjedis të përmendur në pikën 1 të këtij neni;
3. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e veprimeve të inspektoimit. Mungesa e bashkëpunimit vlerësohet bashkë me provat e tjera;
4. Të sigurojë një vend të përshtatshëm për punën e inspektorëve, nëse inspektimi kryhet në vendin e ushtrimit të veprimitarës, si dhe t'u ofrojë atyre qasje të plotë në pajisjet dhe/ose infrastrukturën në posëdim apo administrim;
5. Të paraqesë çdo informacion, të dhënë, ose dokument, si dhe të japë çdo shpjegim për faktet e rrethanat e konstatuara dhe të nevojshme për inspektimin, nëse kërkohet nga inspektorët, duke respektuar edhe afatin kohor të përcaktuar prej tyre;
6. Të lejojë dhe të mundësojë marijen e dëshmive nga punëmarrësit e tij, nëse kjo kërkohet nga inspektorët.

SEKSIONI 3

Të drejtat dhe detyrimet e inspektorëve

Neni 14

Përveç sa parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, inspektorët kanë këto të drejta:

- Të hyjnë dhe të inspektojnë godinat, mjeshterit, objektet, sendet, ku apo nëpërmjet të cilave ushtron veprimtarinë subjekti i inspektoimit, si dhe të inspektojë instalimet, pajisjet, makineritë, produktet, përbërësit dhe çdo send tjetër të lidhur me veprimtarinë, objekt inspektoj, pajisjet, makineritë, produktet,
- Të kërkojnë dhe të marrin kopje të dokumenteve të veprimtarisë, në përputhje me objektin e inspektoimit. Kërkesa pasqyrohet në procesverbalin e inspektoimit. Çdo kopje dokumenti e marrë, nënshtruhet nga përfaqësuesi i subjektit të inspektoimit. Për aq sa është e mundur, kjo pikë zbatohet edhe për dokumentet e ruajtura në trajtë elektronike, regjistrimet elektronike e audiovizive apo të çdo lloj teknologjje tjetër.
- Të kryejnë fotografime, filmime, ose regjistrime me mënyra a mjete të tjera teknike, të mjeshterit, instalimeve, proceseve të punës dhe godinave, objekteve, pajisjeve, produkteve dhe çdo sendi tjetër, që lidhet me veprimtarinë e subjektit të inspektoimit, kudo ku ato ndodhen.
- Të inspektojnë çdo dokument, ose regjistrim të nevojshëm për verifikimin e respektimit të kërkuesave ligjore, përfshirë edhe ato të ruajtura, të krijuara apo të mbajtura në format elektronik, apo çdo teknikë tjetër.
- Të bëjnë matjet e nevojshme për të verifikuar respektimin e kërkuesave ligjore nga subjekti i inspektoimit.
- Të kryejnë verifikime të dokumenteve për identitetin e personave, kur kjo është e nevojshme, sipas objektit të inspektoimit.
- Të kërkojnë subjektit të inspektoimit apo punëmarrësve të tij të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar inspektoimin.

Neni 15

Detyrimet e inspektorëve

- Përveç sa parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, inspektorët kanë këto detyrime:
- Para fillimit të inspektoimit, të prezantohen me anë të dokumentit të identifikimit të institucionit.
 - T'i paraqesin subjektit të inspektoimit urdhrit përkates të inspektoimit.
 - Të evitojnë pikëpamjet të sjelljet në vendin e inspektoimit, që mund të kenë efekt të dëmshëm në parimet e respektit dhe besimit të kërkuar përdorur dëtyrat dhe përgjegjësittë e tyre;
 - Të ruanjë informacionet konfidenciale dhe sekretet tregtarë të marra gjatë inspektoimit, përvëç atyre ligjërisht të autorizuar dhe, gjithashtu, të shmangin përdorimin e tyre, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, ose të tertiortë për përfitim personal, apo për përfitim të palëve të treta;

SESIONI 4

PROCESVERBALI I INSPEKTOIMIT DHE VENDIMI PËRFUNDIMTAR

Neni 16

Mbajtja dhe njotimi i procesverbalit

- Përpara fillimit dhe kryerjes së inspektoimit, inspektorët mbajnë procesverbalin e prezencës, i cili nënshtruhet edhe nga përfaqësuesi i subjektit të inspektoimit që ndodhet në vendin ku kryhet inspektoimi.
- Mospranimi për të nënshtruar procesverbalin e prezencës considerohet moslejim i inspektorëve për të hyrë në mjeshterit ku janë vendosur pajisjet audiovizive të licencuarit dhe/ose të të autorizuarit përdorur kontroll.
- Mosrespektimi i detyrimit parashikuar në nenin 13, pika 1 të kësaj rregulloreje, pavarësisht nënshtruhit të procesverbalit të prezencës, konsiderohet moslejim i inspektorëve për të hyrë në mjeshterit ku janë vendosur pajisjet audiovizive të licencuarit dhe/ose të të autorizuarit.
- Në përfundim të inspektoimit, inspektorët mbajnë procesverbalin e inspektoimit dhe, kur është rasti, edhe proces verbalin e konstatimit të programeve në transmetim, të cilët nënshtruhen edhe nga përfaqësuesi i subjektit të inspektoimit.

5. Prosesverbalet, sipas pikës 4 të këtij neni, si rregull, mbahen në vendin e inspektimit dhe i njoftohen, në përfundim të inspektimit, subjektit të inspektimit nëpërmjet dorëzimit të kopjes në vend.
6. Prosesverbal i inspektimit mund të mbahet edhe në zyrat e AMA-s, kur kundërvajtja lidhet me detyrim e të subjektit, verifikimi dhe konstatimi i të cilave bëhet kryesishët nga organi inspektaues. Në këtë rast, procesverbal i inspektimit i njoftohet subjektit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
7. Prosesverbal i inspektimit përban informacion të hollësisht për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit.
8. Subjekti që inspektohet ka të drejtë të paraqesë, menjëherë, pretendimet e veta lidhur me inspektimin.
9. Në rast se gjykohet e arsyeshme, për shkak të administrimit të një apo disa provave, të cilat nuk mund të administrohen në vend, inspektorët mund t'i lënë një afat kohor subjektit që inspektohet, që të paraqesë pretendimet e veta me shkrim, së bashku me provat në fjalë. Ky fakt pasqyrohet në procesverbal, së bashku edhe me afatin e caktuar prej inspektorëve, afat ky që, në çdo rast, nuk mund të jetë më i shkurtër se 5 (pesë) ditë. Pas kalimit të këtij afati, vendimi përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i subjektit të inspektimit. Shpjegimet apo kontestimet e subjektit të inspektimit janë pjesë e dosjes.
10. Në rast se subjekti i inspektimit refuzon të nënshkruajë procesverbalet, sipas pikës 4 të këtij neni, ky fakt shënohet në procesverbal dhe njoftimi kryhet sipas nenit 81 të ligjit Nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Dorëzimi i procesverbalit përfaqësuesit të subjektit të inspektimit menjëherë në përfundim të inspektimit dhe në vendin ku është kryer inspektimi, konsiderohet si njoftim i procesverbalit, në respektim të nenit 81, Pika 1/a të ligjit Nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Kur kjo nuk mund të realizohet, njoftimi kryhet sipas mënyrave të tjera të parashikuara në ligji.

Neni 17

Shqyrtimi dhe marria e vendimit përfundimtar

1. Në përfundim të inspektimit, inspektorët, në rast se konstatojnë shkelje të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, marrin vendimin përkatës, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
2. Vendimi i inspektorëve i njoftohet subjektit të inspektimit sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 18

Blllokimi i pajisjeve dhe/ose ndalimi i funksionimit të tyre

1. Blllokimi i pajisjeve dhe/ose ndalimi i funksionimit të tyre, si dhe inventarizimi dhe sekuestrimi i tyre bëhet në përpunësie me nenin 80 të Ligjit Nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
2. Në rast se inspektorët, gjatë ushtrimit të inspektimit, zbulojnë se pajisjet transmetuese të subjektit të inspektimit shkaktojnë interferencë të dëmshme, pavarësisht se për përdorimin e tyre është marrë licenca ose autorizimi përkatës, marrin vendimin për blllokimin dhe ndalimin e funksionimit të tyre, i cili i njoftohet përfaqësuesit të subjektit menjëherë.
3. Blllokimi dhe ndalimi i funksionimit të pajisjeve bëhet përmes procesverbalit përkatës të blllokimit dhe ndalimit të funksionimit të tyre, i cili nënshkruhet nga inspektorët, si dhe një përfaqësues i subjektit, kur ky i fundit pranon të nënshkruajë. Në rast se përfaqësuesi i subjektit refuzon nënshkrimin, ky fakt shënohet në procesverbal dhe procesverbal afishohet në vendin e inspektimit.
4. Blllokimi dhe ndalimi i funksionimit të pajisjeve, tregohet me një vulë, përbajtja dhe forma e të cilës përcaktohen nga AMA.
5. Përkundrejt këkesës me shkrim të subjektit që ka shkaktuar interferencën, inspektorët bëjnë verifikimin e nevojshëm dhe, nëse vërejnë se interferencat e dëmshme janë shmangur, vendosin për lejimin e funksionimit të mëtejshëm të pajisjes së ndaluar.
6. Kur një person fizik apo juridik zhvillon veprimtari në fushën e transmetimeve audio dhe/ose audiovizive, të palicencuar, ose të paautorizuar nga AMA, inspektorët marrin vendimin për

bllokimin, inventarizimin dhe sekuestrimin e pajsjeve të përdoruar për ushtrimin e saj, i cili i njoftohet përfaqësuesit të subjektit menjëherë.

7.

Inventarizimi dhe sekuestrimi i pajsjeve bëhet përmes procesverbalit përkatës të bllokimit, inventarizimit dhe sekuestrimit të pajsjeve të përdorura për ushtrimin e veprimtarisë së transmetimeve audio dhe/ose audiovizive pa licencë, ose pa autorizim nga AMA, i cili nënshkruhet përfaqësuesi i subjektit refuzon nënshkrimin, ky fakt shënhohet në procesverbal dhe procesverbal afishohet në vendin e inspektimit.

8.

Kundër vendimit për sekuestrimin mund të bëhet ankrim, brenda 10 (dhjetë) ditëve, në gjykatë. Pas kalimit të afatit të ankimit dhe në rast se, pas ankimit, gjykata vlerëson të ligjshëm sekuestrimin, pajisjet konfiskohen dhe kalojnë në pronësi të shtetit. Konfiskimi bëhet me urdhër të veçantë të Kryetarit të AMA-s.

9.

Për zbatimin e detyrave të këtij nenii, AMA bashkëpunon me autoritetet publike lokale, Policinë e Shtetit dhe shërbimin përbarimor.

KREU IV PROCEDURAT E POSAÇME TË INSPEKTIMIT

SEKSIONI 1 INSPEKTIMI NË FUSHËN E PROGRAMeve

Neni 19

Inspektimi në fushën e programeve

- Me përgjashim të rasteve të parashikuara në ligj, ose në akte të tjera në nënligjore të AMA-s, inspektimi në fushën e programeve kryhet kryesisht, ose me kërkësë të subjektit të interesuar.
- Kur gjatë ushtrimit të detyrave funksionale, administrata e AMA-s konstaton shkelje të legjislacionit për mediat audio dhe audiovizive në fushën e programeve, përgatit relacionin e konstatimit.
- Relacioni duhet të përbajë informacion të hollësisht për subjektin, datën, orën, programin e monitoruar, shkeljen/t dhe çdo veprim tjetër të kryer gjatë procedurës dhe shoqërohet me provat përkatëse, si relacion, regjistrim, fotografi, etj.
- Relacioni, së bashku me çdo dokumentacion tjetër shoqërues, i kalon, sipas kompetencës, kryetarit dhe/ose sekretarit të përgjithshëm të AMA-s.

Neni 20

Shqyrtimi dhe marria e vendimit përfundimtar në fushën e programeve

- Pas vlerësimit të relacionit të konstatimit, si dhe materialit përkatës, sipas nenit 19 të kësaj rregulloreje, kryetari dhe/ose sekretari i përgjithshëm i AMA-s, sipas kompetencës, autorizon vazhdimin e procedurës administrative dhe fillimin e hetimit administrativ.
- Subjekti i inspektimit njoftohet sipas nenit 81 të ligjit Nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Në njoftim shënohet edhe afati brenda të cilit subjekti i inspektimit duhet të jep shpjegime, të dorëzojë çdo dokumentacion dhe/ose material që mund t'i kërkohet, si dhe të paraqesë pretendimet e tij me shkrim, të shoqëruara me provat përkatëse. Sipas rastit, subjektit të inspektimit mund t'i kërkohet që të dëgjohet në një seancë dëgjimore, data dhe ora e së cilës shënohet në njoftim. Subjekti mund të kërkojë të dëgjohet në një seancë dëgjimore, kurdoherë që të dëshirojë, duke njoftuar, më parë, organin e inspektimit.
- Në rast të mos respektimit, nga ana e subjektit të inspektimit, të afatit të përcaktuar në njoftimin, sipas pikës 2 të këtij neni, vendimi përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i tij.
- Parashikimet e pikave 2 dhe 3 të këtij neni nuk e pengojnë organin inspektues të kryejë një inspektim pranë subjektit të inspektimit, sipas Kreut III të kësaj rregulloreje.
- Vendimi përfundimtar i njoftohet subjektit sipas ligjt.



SESIONI 2

INSPEKTIMI NË FUSHËN EKONOMIKO – FINANCIARE

Neni 21

Inspektimi në fushën ekonomiko – financiare

1. Inspektimi në fushën ekonomike – financiare kryhet nga administrata e AMA-s kryesisht.
2. Kur gjatë ushtrimit të detyrate funksionale, administrata e AMA-s konstaton shkelje të legjisacionit për mediat audio dhe audiovizive në fushën ekonomiko - financiare, që lidhen me veprimtarinë ekonomiko – financiare, përgatit relacionin e konstatimit.
3. Relacioni i konstatimit, duhet të përbajë informacion tjetër shoqërohet me subjektin, shkeljen/t dhe çdo veprim tjetër të kryer gjatë procedurës dhe shoqërohet me materialet përkatëse.
4. Relacioni, së bashku me çdo dokumentacion tjetër shoqëruesh, i kalon, sipas kompetencës, kryetarit dhe/o sekrétarit të përgjithshëm të AMA-s.

Neni 22

Shqyrtimi dhe marja e vendimit përfundimtar në fushën ekonomiko - financiare

1. Pas vlerësimit të relacionit të konstatimit, si dhe materialit përkatës, sipas nenit 21 të kësaj rregulloreje, kryetari dhe/o sekrétari i përgjithshëm i AMA-s, sipas kompetencës, autorizon vazhdimin e procedurës administrative dhe fillimin e hetimit administrativ.
2. Subjekti i inspektimit njoftohet sipas nenit 81 të ligjit Nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Në njoftim shënohet edhe afati brenda të cilët, subjekti i inspektimit duhet të jepë shpjegime, të dorëzojë çdo dokumentacion dhe/o se material që mund t'i kërkohet, si dhe të paraqesë pretendimet e tij me shkrim, të shoqëruara me provat përkatëse. Sipas rastit, subjektit mund t'i kërkohet që të dëgjohet në një seancë dëgjimore, data ora e së cilës shënohet në njoftim. Subjekti mund të kërkojë të dëgjohet në një seancë dëgjimore, kur doherë që të dëshirojë, duke njoftuar, më parë, organin e inspektimit.
3. Në rast të mos respektimit, nga ana e subjektit, të afatit të përcaktuar në njoftimin, sipas pikës 2 të këtij nen, vendimi përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i tij.
4. Vendimi përfundimtar i njoftohet subjektit sipas ligjt.

SEKSIONI 3

INSPEKTIMI NË FUSHËN TEKNIKE

Neni 23

Inspektimi në fushën teknike

1. Si irregull, inspektimi në fushën teknike kryhet sipas Kreut III të kësaj rregulloreje.
2. Inspektimi kryhet kryesisht, ose me kërkeshë të palëve të interesuara.
3. Kur gjatë ushtrimit të detyrate të veta funksionale, administrata e AMA-s konstaton shkelje të legjisacionit për mediat audio dhe/o se audiovizive në fushën teknike, përgatit relacionin e konstatimit.
4. Relacioni i konstatimit duhet të përbajë informacion tjetër shoqëruesh, i kalon, sipas datën, orën, shkeljen/t dhe çdo veprim tjetër të kryer gjatë procedurës dhe shoqërohet me provat përkatëse, si regjistrim, fotografi, etj.
5. Relacioni i konstatimit, së bashku me çdo dokumentacion tjetër shoqëruesh, i kalon, sipas kompetencës, kryetarit dhe/o sekrétarit të përgjithshëm të AMA-s.

Neni 24

Shqyrtimi dhe marja e vendimit përfundimtar në fushën teknike

1. Pas vlerësimit të relacionit të konstatimit, si dhe materialit përkatës, sipas nenit 23, të kësaj rregulloreje, kryetari dhe/o sekrétari i përgjithshëm i AMA-s, sipas kompetencës, autorizon vazhdimin e procedurës administrative dhe fillimin e hetimit administrativ.

- Subjekti njoftohet sipas nenit 81 të ligjit Nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Në njoftim shënohet edhe afati brenda të cilët, subjekti i inspektimit duhet të japë shpjegime, të dorëzojë çdo dokumentacion dhe/ose material që mund t'i kërkohet, si dhe të paraqesë pretendimet e tij me shkrim, të shoqëruara me provat përkatëse. Sipas rastit, subjektit të inspektoj mund t'i kërkohet që të dëgjohet në një seancë dëgjimore, data dhe ora e së cilës shënohet në njoftim. Subjekti mund të kërkohet që dëgjohet në një seancë dëgjimore, kurdoherë që të dëshirojë, duke njoftuar, më parë, organin e inspektoj.
- Në rast të mos respektimit, nga ana e subjektit të inspektoj, të afatit të përcaktuar në njoftimin, sipas pikës 2 të këtij nenit, vendimi përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i tij.
- Parashikimet e pikave 2 dhe 3 të këtij nenit nuk e pengojnë organin inspektojues të kryejë një inspektoj pranë subjektit të inspektoj, sipas Kreut III të kësaj rregulloreje.
- Vendimi përfundimtar i njoftohet subjektit sipas ligjit.

SEKSIONI 4

INSPEKTIMI NË FUSHËN ORGANIZATIVE

Neni 25

Inspektoj i fushës organizative

- Kur gjatë ushtrimit të detyrave funksionale, administrata e AMA-s konstaton shkelje të legjisacionit për mediat audio dhe audiovizive në fushën organitive, që lidhen me ndryshime në të dhënat e paraqitura në kërkesën për marrje licence dhe/ose autorizimi, pëgatit relacionin e konstatimit.
- Relacioni i konstatimit, duhet të përbajë informacion të hollësishëm për subjektin, shkeljen/t dhe çdo veprim tjeter të kryer gjatë procedurës dhe shoqërohet me materialet përkatëse.
- Relacioni, së bashku me çdo dokumentacion tjeter shoqëruesh, i kalon, sipas kompetencës, kryetarit dhe/ose sekretarit të përgjithshëm të AMA-s.

Neni 26

Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar

- Pas vlerësimit të relacionit të konstatimit, si dhe materialit përkatës, sipas nenit 25, të kësaj rregullloreje, kryetari dhe/ose sekretari i përgjithshëm i AMA-s, sipas kompetencës, autorizon vazhdimin e procedurës administrative dhe fillimin e hetimit administrativ.
- Subjekti njoftohet sipas nenit 81 të ligjit Nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Në njoftim shënohet edhe afati brenda të cilët, subjekti i inspektoj mund t'i kërkohet, si dhe të jepë shpjegime, të dorëzojë çdo dokumentacion dhe/ose material që mund t'i kërkohet, si dhe të paraqesë pretendimet e tij me shkrim, të shoqëruara me provat përkatëse. Sipas rastit, subjektit të inspektoj mund t'i kërkohet që të dëgjohet në një seancë dëgjimore, data dhe ora e së cilës shënohet në njoftim. Subjekti mund të kërkohet që dëgjohet në një seancë dëgjimore, kurdoherë që të dëshirojë, duke njoftuar, më parë, organin e inspektoj.
- Në rast të mos respektimit, nga ana e subjektit të inspektoj, të afatit të përcaktuar në njoftimin, sipas pikës 2 të këtij nenit, vendimi përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i tij.
- Vendimi përfundimtar i njoftohet subjektit sipas ligjit.

KREU V

ANKIMI ADMINISTRATIV DHE GJYQËSOR

Neni 27

Ankimi administrativ

- Kundër vendimit të personave të autorizuar bëhet ankim në AMA brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni.



2. Ankimi administrativ kundër vendimit të inspektorëve pezullon zbatimin e tij.
3. AMA shqyrtton ankimin dhe merr vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së ankimit.

Neni 28

- Ankimi gjyqësor**
1. Kundër vendimit përfundimtar të AMA-s, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Partë Tiranë.
 2. Ankimi gjyqësor ndaj vendimit përfundimtar të AMA-s nuk e pezullon zbatimin e tij.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 29

Dispozitë kalimtare

Për procedurat administrative, që kanë filiar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, zbatohen dispozitat e rregullores "për miratimin e rregullores "Mbi procedurat e inspektimeve/monitorimit të veprimitarës së ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv", miruar me Nr.21, datë 27.12.2013 të AMA-s.

Neni 30

Formularët bashkëlidhur këtij vendimi janë pjesë përbërëse e tij, në emërtesat përkatëse, si më poshtë vijon:

1. Proses verbal prezence;
2. Proses verbal për inspektimin e veprimitarës audio dhe/ose audiovizive;
3. Proses verbal për konstatimin e programave në transmetim;
4. Vendim për blokimin, inventarizimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të përdorura për ushtrimin e veprimitarës së transmetimeve audio dhe/ose audiovizive.
5. Proses verbal për blokimin, inventarizimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të përdorura për ushtrimin e veprimitarës së transmetimeve audio dhe/ose audiovizive.
6. Vendim për blokimin dhe ndalimin e pajisjeve të përdorura për ushtrimin e veprimitarës së transmetimeve audio dhe/ose audiovizive.
7. Prosesverbal për blokimin dhe ndalimin e pajisjeve të përdorura për ushtrimin e veprimitarës së transmetimeve audio dhe/ose audiovizive.

Neni 31

Shfuqizime

Rregulloja "Për miratimin e rregullores "Mbi procedurat e inspektimeve/monitorimit të veprimitarës së ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv", miruar me Nr.21, datë 27.12.2013 të AMA-s shfuqizohet.

Neni 32

Publikimi

Kjo Rregullore, si dhe çdo ndryshim i saj, publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit të Mediave Audiovizive në internet, pas miratimit të saj.

Neni 33

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga Autoriteti i Mediave Audiovizive.





AUTORITETI
MEDIALE
AUDIOVISIVE

Rruga "Abdi Toptani", 1001, Tiranë | www.ama.gov.al
Tel. +355 4 2226288 | Email: info@ama.gov.al

164

FORMULARËT

(NENI 30)



PROCESVERBAL PREZENCE

I mbajtur sot, në datë _____, në ambientet e subjektit _____, me adresë _____.

Personat e autorizuar të AMA-s:

Bazuar në Urdhrin e Kryetarit të AMA-s Nr. _____, datë _____ “Për inspektimin e veprimitarise së subjekteve (OSHMA), si dhe inventarizimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të përdorura për ushtrimin e veprimitarive të palicencuara/paautorizuara”, njofton subjektin _____ përfaqësuar nga _____ në pozicionin e _____ të këtij subjekti, mbi objektin e Urdhrit Nr. _____, datë _____ të Kryetarit të AMA-s.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 16, pikë 1 të Vendimit të AMA-s Nr. 101, datë 07.06.2017 “Për miratimin e rregullorës “Për procedurat e inspektimit të veprimitarise së ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv”, u mbajt ky procesverbal prezence, për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së inspektimit.

PËR SUBJEKTIN

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
GRUPI I INSPEKTIIMIT



AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
GRUPI I INSPEKTIMIT

PROCES VERBAL

PËR

INSPEKTIMIN E VEPRIMTARISË AUDIOVIZIVE

I mbajtur sot, më datë _____ nga personat a autorizuar të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), sipas Urdhrit Nr. _____ datë _____ të Kryetarit të AMA-s, në subjektin juridik _____

, me adresë _____

në prezencë të përfaqësuesit të subjektit _____ gjatë ushtrimit të inspektimit të veprimtarisë audiovizive të subjektit _____

U KONSTATUA:

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 78 të Ligjit Nr. 97/2013, datë 16.07.2007, "Për mediat audiovizive në republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Vendimin e AMA-s Nr. 101, datë 07.06.2017 "Për miratimin e rregullorës "Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit mediistik audio dhe/ose audioviziv", u mbajt ky processverbal, për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës.

PËR SUBJEKTIN

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
GRUPI I INSPEKTIMIT



AUTORITETI E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
GRUPI I INSPEKTIMEVE

PROCES VERBAL
datë _____ 2017
PËR

KONSTATIMIN E PROGRAMeve NË TRANSMETIM

Bazuar në Urdhrin Nr. _____ datë _____ të Kryetarit të AMA-s, në vijim të proces verbalit të datës _____ grupi i inspektimit të AMA-s, gjatë ushtrimit të kontrollit të ushtruar në subjektin _____ konstatoi transmetimin e programeve (kanaleve) si më poshtë:

- | | | |
|-----|-----|-----|
| 1. | 25. | 49. |
| 2. | 26. | 50. |
| 3. | 27. | 51. |
| 4. | 28. | 52. |
| 5. | 29. | 53. |
| 6. | 30. | 54. |
| 7. | 31. | 55. |
| 8. | 32. | 56. |
| 9. | 33. | 57. |
| 10. | 34. | 58. |
| 11. | 35. | 59. |
| 12. | 36. | 60. |
| 13. | 37. | 61. |
| 14. | 38. | 62. |
| 15. | 39. | 63. |
| 16. | 40. | 64. |
| 17. | 41. | 65. |
| 18. | 42. | 66. |
| 19. | 43. | 67. |
| 20. | 44. | 68. |
| 21. | 45. | 69. |
| 22. | 46. | 70. |
| 23. | 47. | 71. |
| 24. | 48. | 72. |

PËR SUBJEKTIN

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
GRUPI I INSPEKTIMEVE

- | | |
|----|-------|
| 1. | _____ |
| 2. | _____ |
| 3. | _____ |
| 4. | _____ |
| 5. | _____ |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
GRUPI I INSPEKTIMEVE

VENDIM

Datë _____._____.2017

PËR

BLLOKIMIN, INVENTARIZIMIN DHE SEKUESTRIMIN E PAJSJEVE TË PËRDORURA NGA

PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TRANSMETIMEVE AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIVE

Bazuar në Urdhrin Nr. _____ datë _____ të Kryetarit të AMA-s, personat e autorizuar të AMA-s:

Pasi shqyrtuan edhe proces verbalin e datës _____, sipas të cilit rezulton se:

Për sa më sipër, në bazë të nenit 64 dhe nenit 80 të Ligjit nr 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, si dhe Vendimin e AMA-s Nr. 101, datë 07.06.2017 "Për miratimin e rregullores "Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit mediistik audio dhe/ose audioviziv", personat e autorizuar,

VENDOSËN:

- Bllokimin, inventarizimin dhe sekuestrimin e paqisjeve të përdoruara nga _____ për ushtrimin e veprimtarisë së transmetimeve audio dhe/ose audiovizive.
- Kundër vendimit për sekuestrim mund të bëhet ankim brenda 10 (dhjetë) ditëve në gjykatë.
- Pas kalimit të afatit të ankimit dhe në rast se, pas ankimit, gjykata vlerëson të ligjshëm sekuestrimin, paqiset e blokuara konfiskohen dhe kalojnë në pronësi të shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
GRUPI I INSPEKTIMEVE

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

PROCES VERBAL

Datë _____, _____ .2017

PËR

BLLOKIMIN, INVENTARIZIMIN DHE SEKUESTRIMIN E PAJSJEVE TË PËRDORURA NGA

PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TRANSMETIMEVE AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIVE

I mbajtur sot, në datë _____, në ambientet e subjektit _____, me adresë në _____, personat e autorizuar të AMA-s:

bazuar në nenin 80 të Ligjit nr 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e AMA-s Nr. 101, datë 07.06.2017 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat e inspektyimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv”, në Urdhrin Nr. _____ datë _____ të Kryetarit të AMA-s, si dhe Vendimin e datës _____, bëjnë sot sekuestrimin e pajisjeve të përdorura nga _____, sipas inventarit të mëposhtëm:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Numri serial i pajisjes	Tjetër



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
GRUPI I INSPEKTIMEVE

VENDIM
Date _____ PËR _____ .2017

BLLOKIMIN DHE NDALIMIN E FUNKSIONIMIT TË PAJISJEVE TË PËRDORURA NGA

PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TRANSMETIMEVE AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIVE

Bazuar në Urdhrin Nr. _____ datë _____ të Kryetarit të AMA-s, personat e autorizuar të AMA-s:

Pasi shqyrtuan edhe proces verbalin e datës _____, sipas të cilit rezulton se:

Për sa më sipër, në bazë të nenit 64 dhe nenit 80 të Ligjit nr 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Vendimin e AMA-s Nr. 101, datë 07.06.2017 "për miratimin e rregullores "Për procedurat e inspektimeve të veprimit të ofruesve të shërbimit mediistik audio dhe/ose audioviziv", personat e autorizuar,

VENDOSËN:

- Bllokimin dhe ndalimin e funksionimit të pajisjeve të përdoruara nga _____ për ushtrimin e veprimtarisë së transmetimeve audio dhe/ose audiovizive.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankrim në AMA brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
GRUPI I INSPEKTIMEVE**

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
GRUPI I INSPEKTMIT

PROCES VERBAL

Datë _____ · 2017
PËR

BLLOKIMIN DHE NDALIMIN E FUNKSIONIMIT TË PAJISIEVE TË PËRDORURA NGA

PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TRANSMETIMEVE AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIVE

I mbaitur sot, në datë _____, në ambientet e subjektit _____,
me adresë _____,
personat e autorizuar të AMA-s:

bazuar në nenin 80 të Ligjit nr 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, në Vendimin e AMA-s Nr. 101, datë 07.06.2017 "Për miratimin e irregullores "Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv", në Urdhrin Nr. _____ datë _____ të Kryetarit të AMA-s, si dhe Vendimin e datës _____, bëjnë sot bllokimin dhe ndalimin e pajisjeve të përdorura nga _____ për ushtrimin e veprimtarisë së transmetimeve audiovizive, sipas inventarit të mëposhtëm:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Numri serial i pajisjes	Tjetër
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				
29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				
36				
37				
38				
39				
40				
41				
42				
43				
44				
45				
46				
47				
48				
49				
50				
51				
52				
53				
54				
55				
56				
57				
58				
59				
60				
61				
62				
63				
64				
65				
66				
67				
68				
69				
70				
71				
72				
73				
74				
75				
76				
77				
78				
79				
80				
81				
82				
83				
84				
85				
86				
87				
88				
89				
90				
91				
92				
93				
94				
95				
96				
97				
98				
99				
100				